VENDIM
Nr. 96, datë 4.7.2017

MBI SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMIT TË ERE-S NR. 115, DATË 7.8.2016, "MBI PËRCAKTIMIN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 2 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", vendimit nr. 449, datë 15.6.2016, të Këshillit te Ministrave, "Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike" dhe nenit 8 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi shtyrjen e afatit të vendimit të ERE-s nr. 115, datë 7.8.2016, "Mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 449, datë 15.6.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar "Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike".

- Në pjesën III, të VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar "Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike." Parashikohet se deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas këtij vendimi, ERE cakton përkohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e furnizuesit të mundësisë së fundit.

- Me VKM-në nr. 244, datë 30.3.2016, janë miratuar "Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike".

- Në VKM-në nr. 244, datë 30.3.2016, është parashikuar se: detyrimi i shërbimit publik përfshin ndër të tjerë KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., ku kjo e fundit do të sigurojë blerjen e energjisë elektrike për qëllime të shërbimit universal nga KESH sh.a.

- Me vendimin nr. 195, datë 30.12.2016, bordi i ERE-s vendosi mbi shtyrjen e afatit të vendimit të ERE-s nr. 115, datë 7.8.2016, mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike deri në 30 qershor 2017.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën 1 të vendimit të ERE-s nr. 115, datë 7.8.2016, deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti